



BASHKIA KUÇOVË
Drejtoria e Urbanistikës dhe e Strehimit

NJOFTIM

PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE

Në mbështetje të ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale të strehimit” të ndryshuar si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 614, datë 07.07.2015 “Për përcaktimin e procedurave të privatizimit të banesave dhe objekteve të kthyera në fond banese, me vendime të organeve të qeverisjes vendore, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore dhe të shtetit, ku janë sistemuar me strehim banorë të pajisur me autorizim nga organet kompetente” i ndryshuar do të fillojë procedura e privatizimit të banesave dhe objekteve të kthyera në fond banese me vendime të organeve të qeverisjes vendore, për banorët që janë sistemuar me strehim në këto banesa, në bazë të autorizimeve përkatëse, të lëshuara nga organet kompetente, për territorin e Bashkisë Kuçovë, fillon mbi bazën e kërkesës së bërë nga vetë qytetarët.

Kush mund të bëjë kërkesë për privatizim?

Kërkesa për privatizim bëhet nga:

- A) Subjekti i pajisur me autorizim nga organet kompetente ose, në rast vdekje, të trashëgimtarëve të tij, ose
- B) të çdo personi të autorizuar me prokurë nga subjekti i përcaktuar në pikën A), më sipër.

Afati kohor i dërgimit të kërkesës!

Kërkesa duhet të dërgohet në rrugë postare (letër rekomande) drejt njësisë qeverisjes vendore, Bashkia Kuçovë, brenda datës 30.04.2018 i përcaktuar sipas VKM.

Çfarë përmban kërkesa për privatizim?

Kërkesa duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- Të dhënat e njësisë së qeverisjes vendore (*Njësia Vendore => Bashkia Kuçovë*).
- Të dhënat personale të subjektit kërkues (*emër/ atësia/ mbiemër/ datëlindja/ vendlindja/ numri personal/ letër njoftimi/ shtetësia/ lagja e banimit/ ...*)
- Të dhënat në lidhje me banesën ose subjektin e kthyer në fond banese. (*adresa, dokumente shitesë që mund të ketë subjekti kërkues*)
- Datën e kërkesës (*__/ __/ 2017*)
- Nënshkrimi i kërkuesit (*emër/ mbiemër/ firëm*).

Cilat janë dokumentet që shoqërojnë kërkesën?

Dokumentet që duhet të shoqërohen me kërkesën e mësipërme, janë:

- Autorizimin për strehim, të lëshuar nga organet kompetente.
- Çertifikatën e gjendjes familjare të **3 (tre)** muajve të fundit.
- Dokumentin e identifikimit të kërkuesit (fotokopje kartë identiteti dhe/ ose pasaportë biometrike)
- Gjithe dokumentet që dispononi për objektin që jetoni